

KRM “PASTRIMI”-PRISHTINË



INFORMATAT E PËRGJITHSHME LIDHUR ME NDARJEN E ZONAVE



Njësia e Bartjes - PRISHTINË

Korrik, 2021

PLANI OPERATIV PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS – NDARJA E QYTETIT NË ZONA DHE NËNZONA

Në bazë të kushteve të parapara me marrëveshjen në mes Komunës së Prishtinës dhe KRM Pastrimit, si dhe nevojave të paraqitura në terren është iniciuar ndryshimi i planit operativ. Në bashkëpunim me GIZ, dhe zyrtarët përgjegjës nga Komuna e Prishtinës, KRM Pastrimi ka hartuar planin e ri operativ me përmbajtje si në vijim:

I tërë qyteti është ndarë në pesë zona të operimit, ku shërbimi derë më derë në një zonë tani e tutje do të kryhet brenda një dite të caktuar.

Zonat ku shërbimi kryhet me kontejnerë përfshijnë pjesën urbane të qytetit. Ky shërbim kryhet çdo ditë.

Orari i shërbimit me kontejnerë mund të pësojë ndryshime të kohëpaskohshme, në funksion të zhvillimit të qytetit dhe kërkesave për ngritje të nivelit të shërbimit nga Komuna e Prishtinës.

Ndarja e qytetit është planifikuar si në vijim:

Zona e parë – me operim në ditën e Hënë;

Zona e dytë – me operim në ditën e Martë;


Zona e tretë – me operim në ditën e Mërkurë;

Zona e katërt – me operim në ditën e Enjte;

Zona e pestë – me operim në ditën e Premte;

Zonat me kontejnerë – me operim çdo ditë, deri në 5 herë brenda ditës.

Qyteti i Prishtinës - Ndarja në Zona




Zona e parë – me operim në ditën e Hënë

Gjatë ditës së **Hënë** operohet nga ora 07:00-15:00;

Të përfshira janë lagjet: Spital, Mat-I, Matiçan, Zllatar, Aktash, Muhaxher, Dodonë, Taukbahqe, Velani.

Ndërrimi i parë: 14 kamionë dhe 2 kamioneta:

- Shërbimi derë më derë brenda **Zonës së parë** kryhet në **14 nënzona**.




Zona e dytë – me operim në ditën e Martë

Gjatë ditës së **Martë** operohet nga ora 07:00-15:00;

Të përfshira janë lagjet: Normale, Taslixhe, Vreshtat, Gjinaj, Bledi, Medrese, Qamëri, Kolovicë, Gallap.

Ndërrimi i parë: 14 kamionë dhe 2 kamioneta:

- Shërbimi derë më derë brenda **Zonës së dytë** kryhet në **14 nënzona**.




Zona e tretë – me operim në ditën e Mërkurë

Gjatë ditës së **Mërkurë** operohet nga ora 07:00-15:00;

Të përfshira janë lagjet: Hajvali dhe Veternik (ana e majtë nga rruga kryesore).

Ndërrimi i parë: 9 kamionë dhe 2 kamioneta:

- Shërbimi derë më derë brenda **Zonës së tretë** kryhet në **9 nënzona**.



Zona e katërt – me operim në ditën e Enjte

Gjatë ditës së **Enjte** operohet nga ora 07:00-15:00;

Të përfshira janë lagjet: Kodër e Trimave dhe Sinidoll.

Ndërrimi i parë: 10 kamionë dhe 2 kamioneta:

- Shërbimi derë më derë brenda **Zonës së katërt** kryhet në **10 nënzona**.




Zona e pestë – me operim në ditën e Premte

Gjatë ditës së **Premte** operohet nga ora 07:00-15:00;

Të përfshira janë lagjet: Tophane, Pejton, Arbëri, Besianë, Përro i Njelmët.

Ndërrimi i parë: 12 kamionë dhe 2 kamioneta:

- Shërbimi derë më derë brenda **Zonës së pestë** kryhet në **12 nënzona**.



Zonat me kontejnerë – me operim çdo ditë, deri në 5 herë brenda ditës

Zona Qendër

Në zonën Qendër ofrohet shërbimi 5 herë në 24 orë. Ky shërbim kryhet çdo ditë.

Shërbimi ofrohet në tre ndërrime me makineri: 4 kamionë dhe 2 kamioneta.

Orari i shërbimit është: 06:00; 09:00; 14:00; 18:00; 21:00



Lagjeja Ulpianë

Në lagjen Ulpiana ofrohet shërbimi 1 herë në 24 orë me përjashtim të disa pikave “të nxehta” ku ofrohet shërbim dy herë. Ky shërbim kryhet çdo ditë.

Shërbimi ofrohet në ndërrimin e dytë dhe të tretë me makineri: 2 kamionë dhe 2 kamioneta.

Orari i shërbimit është: 14:00; 21:00.



Lagjet Kodër e Diellit dhe Mati I

Në lagjen Kodra e Diellit dhe Mati I ofrohet shërbimi 1 deri në 3 herë në 24 orë. Ky shërbim kryhet çdo ditë.

Shërbimi ofrohet në 3 ndërrime me makineri: 5 kamionë dhe 2 kamioneta.

Orari i shërbimit është: 07:00; 14:00; 21:00.




Lagjet Kalabria, Janinë dhe Qëndresë

Në lagjet Kalabria, Janina dhe Qëndresa ofrohet shërbimi me kontejnerë 1 deri në 3 herë në 24 orë. Ky shërbim kryhet çdo ditë. Derisa duke pasur parasyshë strukturën e ndërtimit jo të njëtrajtshëm, në disa pjesë ofrohet edhe shërbimi derë më derë. Shërbimi derë më derë ofrohet:

- Në lagjen Janina ditën e **Enjte**;
- Në lagjen Qëndresa ditën e **Premte**.

Shërbimi me kontejnerë ofrohet në 3 ndërrime me makineri: 5 kamionë dhe 2 kamioneta.

Orari i shërbimit është: 07:00; 14:00; 21:00.




Lagja Hajvali

Në lagjen Hajvalia ofrohet shërbimi me kontejnerë 3 herë në javë, një herë gjatë ditës, varësisht nga sasia e mbeturinave. Ky shërbim ofrohet ditën e **Hënë**, ditën e **Mërkurë** dhe ditën e **Premte**.

Shërbimi me kontejnerë ofrohet në ndërrimin e parë me makineri: 1 kamion dhe 1 kamionetë.

Orari i shërbimit është: 07:00-15:00.



OPERIMI NË ZONËN RURALE:

E Martë:

1. Bërnice e Poshtme;
2. Trudë;
3. Lebanë (te “Gama”);
4. Prugoc (pjesërisht – referohuni në file “Ndryshimet në orar”);
5. Vranidoll (lagjet: Avdullahaj, Verbocët, Brestocët);
6. Sharban;
7. Barilevë (lagja Gashtë);
8. Drenoc (lagja Xhafollët).

E Mërkurë:

1. Siqevë;
2. Sinidoll;
3. Magjistranja Bardhosh – Lebanë;
4. Rimanishtë;
5. Lebanë;
6. Fshati Bardhosh (përveç dy rrugëve – referohuni në file “Ndryshimet në orar”);
7. Rr. Basri Canolli;
8. Llukar (lagja Berishët – vetëm rrugicat, lagja Kullaj – vetëm rrugicat);
9. Makoc (anësoret);
10. Grashticë (anësoret);
11. Barilevë (përveç lagja Gashtë);
12. Drenoc (përveç lagja Xhafollët);
13. Teneshdoll;
14. Vranidoll (përveç lagja Avdullahaj);
15. Besi;
16. Prugoc (lagjet: 1, 2, 3 ,4, 5).

E Enjte:

1. Shkabaj;
2. Milevc;
3. Suteskë;
4. Llaishec (Dragoc);
5. Shashkoc;
6. Llukar (rruga kryesore në lagjet Berishët dhe Kullaj);
7. Rruga kryesore Makoc – Grashticë;
8. Mramor;
9. Zllash;
10. Busi;
11. Marec;
12. Mukatë;

13. Slivovë;
14. Kukavicë;
15. Bërnice e Epërme;
16. Bardhosh (dy rrugë – referohuni në file “Ndryshimet në orar”).

E Premte:

1. Koliq;
2. Keqekollë;
3. Ballaban;
4. Nishec;
5. Radashec;
6. Prapashticë;
7. Dabishec;
8. Hajkobillë;
9. Glllogovicë.